



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

OSNOVNI SUD GNJILANE

Broj predmeta: 2019:264135

Dana: 23.12.2022

Broj dokumenta: 03791321

C.nr.1008/19

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN-Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari Milorad Mitković, me bashkëpunëtorin profesional Baki Sylejmani, duke vendosur në çështjen juridike kontestimore të paditësit M.M.nga Gj. të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Vehbi Ismajli avokat nga Prishtina, Lagja e Re rr."Pëëumb Ademaj",. Pa nr.Hajvali, kundër të paditurës S.U.G.A. Sh.A nga P., të cilën e përfaqëson përfaqësuesi i saj Sokol Dardha nga Prishtina, me bazë juridike kompensim dëmi material dhe jomaterial, në seancën e shqyrtimit kryesor-publik, në prani të palëve, të mbajtur me datën 20.10.2022, mori këtë:

AKTGJYKIM

I.APROVOHET pjesërisht si e bazuar kërkesëpadia e paditësit M.M.nga Gj, të cilin e përfaqëson Vehbi Ismajli, avokat nga Prishtina, dhe **OBLIGOHET** e paditura S.U.G.A. Sh.A nga P., që paditësit në emër të kompensimit të dëmit material dhe jo material (lidhur me aksidentin e komunikacionit të datës 26.09.2019 rreth orës 23:10 minuta, i cila cili ka ndodhur në fshatin Parallovë, t'ia paguaj shumën e përgjithshme prej 6,480.00€ edhe atë:

- në emër të dhimbjeve fizike trupore të përjetuara shumën prej 2,000.00 €
 - në emër të dhimbjeve shpirtërore për frikën e përjetuar shumën prej 1,400.00€- në emër të zvogëlimit të aktivitetit jetësor 3% shumën 2,000 €-
 - ndihmë nga personi i tretë, shumën prej 5,00€-
 - ushqim të përforcuar, shumën prej 385 €
 - Në emër të shpenzimeve të shërimit shumën prej 201 €
- të gjitha këto me kamatë ligjore prej 8%, duke filluar prej datës 20.10.2022, si ditë e nxerrjes së aktgjykimit e deri në pagesën definitive, në afat prej 15 ditësh, pas plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

II. REFUZOHET si e pabazuar kërkesëpadia e paditësit me të cilën ka kërkuar, që gjykata ta obligojë të paditurën, sipas të njëjtës bazë që paditësit në emër të dëmit material dhe jomaterial, t'ia paguaj shumën prej 12,850.000.€, përtej shumë së gjykuar edhe ate për:

Dhimbje fizike edhe ate shumën prej 2,750€

Frikën e përjetuar ëshumën prej €- 3,3500€

Ndihmë nga personi i tretë shumën prej 3,050 €

Në emër të fitimit të humbur shumën prej 2,200.00

Në emër të zvogëlimit të aktivitetit jetësor shumën prej 1,500. €

II. OBLIGOHET e paditura që paditësit t'ia kompensojë shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 1,918.20€, në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit, ndërsa për shumën e kërkuar në lartësi prej 917.20 €, të kërkuar më tepër se shuma e gjykuar refuzohet si e pabazuar .

A r s y e t i m

Paditësi, respektivisht i autorizuari i paditësit, në këtë gjykatë më datë 13.11.2019, ka paraqitur padi, kundër të paditurës S.U.G.A. Sh.A nga P., për kompensimin e dëmit material dhe jo material lidhur aksidentin e komunikacionit i cili ka ndodhur më datën 26.09.2019 rreth orës 23:10 minuta në fshatin Parallovë afër pikës së karburantit “Vullkan Petrollë”, të datës 14.01.2019, në cilësi të pasagjerit në automjetin me tabela të regjistrimit 06-414-CQ, automjeti i siguar tek e paditura me policë të sigurimit 0007083492 të cilën e ka drejtuar vozitësi V.Xh.nga Gj.i siguar tek e paditura. Në precizimin e kërkesëspadisë në shqyrtimin e fundit të datës 20.10.2022, me të cilën ka kërkuar kompensimin e dëmit material dhe jo material për të gjitha llojet në shumën prej 16,141.00€, të cilën gjykata e konsideron gabim teknik, pasi që me rastin e llogaritjes një nga një ka ardhur në përfundim se shuma e përgjithshme 18,986.00 €, me kamatë ligjore konform nenit 382 paragrafi 2 i LMD-së, si dhe i ka kërkuar shpenzimet e procedurën kontestimore në shumë prej 2835.40 €.t

Në padi dhe gjatë shqyrtimit gjyqësor ka theksuar se deri te aksidenti i komunikacionit ka ardhur në vendin kritik ka ardhur deri te aksidenit i komunikacioni, ashtu që nga pakujdesi dhe duke mos u përshtatë shpejtësinë e lëvizjes me kushtet e rrugës e humb kontrollin mbi automjetin dhe me pjesën e përparme të anës së djathtë e godet kodrën dhe më pas e largon veturën nga vendi i ngjarjes. Dhe si pasojë në këtë aksident lëndime të rënda trupore kanë pësuar edhe i siguruari i të paditurës si vozitës dhe paditësi si pasagjer në automjetin e lartcekur dhe për këtë arsye kanë kërkuar ndihmë mjekësore në Qendrën Emergjente në Spitalin Regjional në Gjilan ku paditësi ka pësuar lëndime të rënda trupore. I ka kundërshtuar pretendimet e të paditurës në përgjigje në pad dhe në shqyrtimet gjyqësore. I ka propozuar gjykatës që t'i adminstrojë provat e propozuara dhe ka kërkuar nga gjykata që të aprovohet kërkesëpadia e tij dhe të obligohet e paditura që t'ia kompensojë dëmin material dhe jo material si në shqyrtimin gjyqësor të mbajtur më datën 20.10.2022. Provat i ka propozuar shpenzimet e procedurës i ka kërkuar duke i specifikuar.

E paditura në përgjigjenë padi të datës 11.09.2020, por edhe gjatë shqyrtimit e ka kundërshtuar kërkesëpadinë e paditësit si për nga baza juridike, edhe për nga lartësia duke shtuar se nuk ka prova që deri te aksidenti në të cilën paditësi ka pësuar lëndime trupore ka ardhur me fajin e të siguarit të të paditurës dhe kërkesëpadija e paditësit është shumë e lartë për të gjitha llojet e kompenzimit të dëmit material dhe jomaterial, ashtu që përmes ekspertit të kompanisë së paditur “Censor”, paditësi ka pësuar lëndime të lehta trupore, në mungesë të provave të përgjegjësive penale të siguarit të paditurës nuk ekziston as edhe baza juridike. Provat e ka propozuar, shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

Për vërtetimin e drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, relevante për nxjerrjen e vendimit të drejtë dhe të ligjshëm, gjykata i ka shtjelluar provat e propozura edhe ato: Padija e paditësit e datës 13.11.2019; Raporti policor i aksidentit me nr.2019-CR-583 i dt.26.09.2019; Udhëzimi i datës 30.09.2019 së bashku me diagnozën dhe terapinë e dhënë nga ana e dr. Musa Jashari; Raporti nga konsulta e Spitalit të Gjilanit me nr 5672, i datës 03.10.2019; Dëftesat për pagim e participim të cilat shërbejnë si provë nga faqja 0 deri në faqen 4; Raporti i mjekut i datës 02.12.2019, pa numër; Numër 100/43 i datës 21.11.2019, pa nr, nga data 11.10.2019 dhe nga data 14.11.2019 nr 9782 nga data 14.11.2019 dhe nr 9515, nga data 24.10.2019 nr 22952, nga data 26.09.2019 nr 958, nga data 02.2019 nr 3444-5, nga data 14.10.2019 nr 13933, nga data 14.10.2019 nr 18540, nga data 10.10.2019 nr 8310, nga data 03.10.2019 dhe shtatë pagesa lidhur me shpenzimet, fletëlëshimi dhe numri i historisë 11-292 Spitali i Përgjithshëm Gjilan, përgjegjja në padi me nr të protokolit 782 e datës 11.09.2020, Aktgjykimi- Departamenti për Kundërvajtje me nr.K.nr.1268/19 i datës 07.10.2020; Kërkesa për inicimin e procedurës kundërvajtëse; Ekspertiza e ekspertit psikiatër dr. Shkelzen Kadriu e datës 09.03.2021; Ekspertiza e ekspertit ortoped dr. Musa Jashari e datës 09.03.2021, Ekspertiza e ekspertit ortoped dr. Abdylatif Latifi e datës 25.06.2021; Ekspertiza e ekspertit ortoped dr. Sabit Sllamniku e datës 12.10.2022 si dhe Ekspertiza e grupit të ekspertëve të Fakultetit të Mjekësisë në Prishtinë i datës 10.08.2021.

Në bazë të Raporti policor të aksidentit me nr.2019-CR-583 i dt.26.09.2019, është vërtetuar se më 26.09.2019, në ora 23:10 në fshatin Parallovë, afër pikës së karburantit Vullakan Petrollëv, ka ardhur deri te aksidenti i komunikacionit në të cilën kanë marrë pjesë i siguruari i të paditurës V.Xh. nga Gj. i cili e ka drejtuar automjetin e markës Opell Corsa me tabela të regjistrimit 06-414-CQ dhe paditësi M.M., i cili e ka qenë pasagjer i paditësit.

Nga Udhëzimi i datës 30.09.2019 së bashku me diagnozën dhe terapinë e dhënë nga ana e dr. Musa Jashari, gjykata vërtetoi faktin se paditësi fillimisht është drejtuar në këtë institucion ku eksperti ka dhënë mendimin e tij.

Nga raporti nga konsulta e Spitalit të Gjilanit me nr 5672, i datës 03.10.2019, është vërtetuar se paditësi M.M pas fatkeqësisë së komunikacionit është trajtuar në institucionin e lartpërmendur shëndetësor, për shkak të lëndimeve të pësuar në fatkeqësinë e komunikacionit.

Nga Dëftesat për pagim e participim të cilat shërbejnë si provë nga faqja 0 deri në faqen 4, gjykata vërtetoi faktin se këto janë dëftesat ne emër të paditësit M.M

Nga Raporti i mjekut i datës 02.12.2019, pa numër; nr. 100/43 i datës 21.11.2019, pa nr, nga data 11.10.2019 dhe nga data 14.11.2019 nr 9782 nga data 14.11.2019 dhe nr. 9515, nga data 24.10.2019 nr 22952, nga data 26.09.2019 nr 958, nga data 02.2019 nr 3444-5, nga data 14.10.2019 nr 13933, nga data 14.10.2019 nr 18540, nga data 10.10.2019 nr 8310, nga data 03.10.2019 dhe shtatë pagesa lidhur me shpenzimet, fletëlëshimi dhe numri i historisë 11-292 Spitali i Përgjithshëm Gjilan, gjykata vërtetoi faktin se i njëjti ka qenë në shërbim në këto instucion shëndetësor.

Nga Aktgjykimi Departamenti për Kundërvajtje me nr.K.nr.1268/19 i datës 07.10.2020, gjykata vërtetoi faktin se i siguruari i të paditurës V.V.Xh. është përgjegjës dhe është denaur me gjobë në shumë prej 150 €.

Nga Kërkesa për iniciimin e procedurës kundërvajtëse, gjykata vërtetoi faktin se I njëjti fillimisht I është drejtuar me kërkesë për iniciimin e rastit në Divizionin për Kundërvajtje.

Nga Ekspertiza e ekspertit psikiatër dr.Shkelzen Kadriu e datës 09.03.2021, gjykata vërtetoi faktin se paditësi ka pasur frikë primare të intesitetit të lartë ku i njëjti ka përjetuar një reaksion stresi akut i cili ka zgjatë disa sekonda, ndërsa frikë sekundare të intesitetit të lartë 4 ditë, frikë të intesitetit të mesëm 4 javë dhe frikë të intesitetit të lehtë dy muaj të cilës ekspertizë gjykata, i'a fali besimin e plotë ngase është punuar në mënyrë profesionale dhe nga eksperti profesional i cili ka një përvojë të gjatë në këtë lëmi.

Në bazë të konstatimit të grupit të ekspertëve të dhënë në super ekspertizën e datës 09.08.2022 nga Dr.Vjollca Bince - ortoped traumatolog dhe Dr.NexhmedinUruqi - ortoped traumatolog , dhe dr.Gani Jashanica-ortoped- Traumatolog, është vërtetuar se paditësi ka pasur dhimbje të intesiteti posaqërisht të lartë 30 minuta, dhimbjet të intesiteti të rëndë 24 orë, intesitet të mesëm 14 ditë dhe me intesitet të ulët ende, ka zvogëlim të aktivitetit jetësor në shkallë prej 3% që është si pasojë e zvogëlimit të lëvizshmërsë, ndihma në personin e tretë ka qenë dhe është e nevojshme në kohëzgjatje 4 javë, ushqim i përforcuar ka qenë i nevojshëm 2 muaj si dhe rehabilitizik fiziko terapeutik dhe psikik ka qenë i nevojshëm vitine parë 2 herë nga 10 ditë dhe atë për pretendimin e kufizimit të lëvizjeve të qafes dhe përforcimin e muskujve të përparëm dhe të pasëm të qafes, (të cilës super ekspertizë gjykata ia fali besimin e plotë nga se është punuar në mënyrë profesionale dhe nga ekspertëtë profesionist të cilët kanë një përvojë të gjatë në këtë lëmi)

Me vlerësimin e fakteve të pakontestueshme, thënieve të palëve dhe provave të shtjelluara edhe atë secilës veç e veç dhe të gjithave së bashku, në pajtim të nenit 8 të LPK, gjykata ka përfunduar se kërkesëpadia e paditësit është pjesërisht e bazuar dhe ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi për arsyet si në vijim:

Në rastin konkret i siguruari i të paditurës V.Xh. me aktgjykimin e Gjykatës Themlore në Gjilanin-Divizioni për Kundërvajtje është përgjegjës dhe është denaur me gjobë në shumë

prej 150 eurove, pasi që ka shkaktuar aksident komunikacioni në të cilën M.M si pasagjer i të siguarit të paditurës ka pësuar lëndime trupore. Andaj, ekzistimi i fajësisë së dëmtuesit, si bazë për kompensimin e dëmit të shkaktuar, është vërtetuar me aktgjykimin e plotfuqishëm në Divizionin për kundërvajtje, ndërkaq në rastin konkret e paditura, në pajtim me nenin 136 par.1 të LMD me të cilin është paraparë që dëmtuesi është i obliguar që ta kompensojë dëmin nëse nuk e provon se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij, nuk e ka dëshmuar të kundërtën, se dëmi nuk është shkaktuar me fajin e të siguarit të tij. Sipas dispozitave të nenit 319 lidhur me nenin 322 par.2 të LPK, barra e provës së këtij fakti bie mbi të paditurën. Përkundrazi, në procedurën e provave sipas propozimit të të paditurës gjykata e ka shtjelluar provën përmes grupit të ekspertëve të cilët edhe pse kanë prezentuar në shqyrtimin e fundit gjyqësor, palët ndërgjyqëse nuk e kanë kontestuar këlthë superekspertizë dhe janë pajtuar që të njëjti mos të dëgjohen.

Intensitetin e kohëzgjatjes së dhimbjeve fizike dhe frikës, gjykata e ka vërtetuar në bazë të suprekspertizës së grupit të ekspertizave të ortopedis – traumatolog dhe psikiatrit, të cilat ekspertiza gjykata i ka pranuar në tërësi, pasi që janë dhënë nga ana e ekspertëve profesional, ndërkaq nga ana tjetër palët nuk kanë pasur vërejtje ndaj ekspertizave në fjalë.

Nga të cekurat më lartë del se e paditura është e obliguar që paditësit t'ia kompensojë dëmin në pajtim me nenin 136 par.1 dhe 2 lidhur me nenin 159 par.1 të LMD, në pajtim me nenin 9 dhe 10 të Ligjit 04/L-018 për sigurimin e detyrueshëm nga autopërgjegjësia, sepse paditësi ka pësuar dëm në fatkeqësinë e komunikacionit të shkaktuar me fajin e drejtuesit të automjetit i cili është i siguar tek e paditura, pa marrë parasysh fajin e vet të paditurës, sipas përgjegjësisë objektive, sepse dëmi del nga sendi i rrezikshëm automjetit në lëvizje dhe veprimtarisë të cilën e ushtron e paditura.

Lartësinë e kompensimit të dëmit material, gjykata e ka vërtetuar në bazë të faturave fiskale, të dorëzuara nga ana e paditësit, lidhur me shpenzimet për shërim, duke marrë parasysh mendimin e grupit të ekspertëve të ortopedisë se paditësi ka pasur nevojë për ndihmën e personit të tretë në kohëzgjatje prej 4 javë, ushqim të përforcuar 2 muaj, andaj paditësit ia ka caktuar kompensimin e dëmit material si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Kërkesëpadinë në pjesën refuzuese për të gjitha llojet e dëmit, gjykata e ka konsideruar si tejet të lartë në krahasim me shkeljen e të mirave përkatësisht lëndimet e pësuar, duke pasur parasysh qëllimin e kompensimit të dëmit jomaterial dhe se me këtë paditësi nuk pretendon që të pasurohet, e cila është e papajtueshme me natyrën dhe qëllimin e kompensimit e cila i shërben paditësit që të përjetojë satisfakcion në kuptim të përjetimit të kënaqësisë e cila paditësit do t'i ndihmojë për tejkalimin e krizës psikike, fizike dhe frikës së përjetuar në pajtim me nenin 183 par.1 dhe 2 të LMD, ndërkaq për dëmin material sa i përket fitimit të humbur gjykatës i njëjti nuk i ka ofruar asnjë provë se i njëjti ka qenë në mardhënie pune apo ka patur kontratë pune.

Në bazë të gjendjes së vërtetuar faktike, del se e paditura është e obliguar që paditësit t'ia kompensojë dëmin në pajtim të nenit 136 par.1 dhe 2 lidhur me nenin 159 të LMD, sepse paditësi ka pësuar dëm në fatkeqësinë e komunikacionit të shkaktuar me fajin e drejtuesit të automjetit të siguruar tek e paditura, pa marrë parasysh fajin e paditësit, pasi që dëmi pamëdyshje rrjedh nga sendi i rrezikshëm lidhur me veprimtarinë të cilën e ushtron e paditura.

Në shumat e caktuara të kompensimit të dëmit e paditura është e obliguar që paditësit t'ia paguajë edhe kamatën e caktuar, si në dispozitiv të aktgjykimit, në pajtim me dispozitat e nenit 382 të LMD.

Gjykata i ka vlerësuar edhe provat e tjera dhe thëniet e palëve, por të njëjtat nuk i ka arsyetuar në mënyrë të veçantë, ngase nuk kanë pasur ndikim për vendim ndryshe të gjykatës.

Vendimi për shpenzimet e procedurës është bazuar në nenin 452 par.1 dhe nenin 453 par.1 dhe 2 të LPK, në pajtim me TA dhe paditësit ia ka caktuar vetëm shpenzimet e domosdoshme të procedurës kontestimore në shumë të përgjithshme prej 1,918.20€, edhe atë: për taksë gjyqësore për padi shumën prej 100 €, për përpilim të padisë shumën prej 104 €, për 5 seanca të mbajtur shumën prej 676 euro, për dy seanca të shtyra shumën prej 135.20 euro, për ekspertiza të eksperit psikiatgër dhe ortoped shumën prej 402 euro si dhe për superekspertizë shumën prej 501 euro, ndërsa pjesën tjetër në shumë preju 917,20 euro të kërkaur më tepër shuma e gjykuar e refuzoi si të pabazaur ngase paditësi ka patur pjesërisht sukses në marrjen e ktëijnn aktgjykimi.

Nga të cekurat më lartë dhe nenit 142 par.1 dhe 3 dhe nenit 143 par.1 të LPK, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjyqtari,
Milorad Mitković,

KËSHILLA JURIDIKE: kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej 15 ditë, nga dita e pranimit të të njëjtit, përmes kësaj gjykate, në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.